



**SUBJEKTI:** ADRIA FERRIES MERR ME QIRA GNV PEGASUS PËR SEZONIN VEROR 2026

### **Garantohet vazhdimësia e plotë e lidhjeve Bari–Durrës**

Adria Ferries njofton se ka arritur një marrëveshje me GNV për marrjen me qira të anijes GNV Pegasus, e cila do të vihet në shërbim në linjën Bari–Durrës gjatë sezonit veror 2026.

Marrëveshja, fryt i bashkëpunimit ndërmjet dy kompanive, ka bërë të mundur identifikimin në një kohë të shkurtër të një zgjidhjeje operative efikase në dobi të pasagjerëve, operatorëve turistikë dhe rrjetit të agjencive.

Adria Ferries dëshiron të falënderojë GNV për gatishmërinë dhe frymën e bashkëpunimit të treguar. Përdorimi i GNV Pegasus do të mundësojë garantimin e vazhdimësisë së plotë të shërbimit, duke ruajtur standarde të larta komoditeti, besueshmërie dhe cilësie operative. Ky operacion konfirmon angazhimin e Kompanisë ndaj klientëve dhe partnerëve të saj tregtarë, duke forcuar më tej rolin e saj si pikë referimi në lidhjet detare ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë.

Përfundimi me sukses i kësaj marrëveshjeje dëshmon aftësinë e Adria Ferries për të përballuar me shpejtësi sfidat operative, duke vënë në dispozicion kompetencat, marrëdhëniet dhe burimet e nevojshme për të garantuar një shërbim në përputhje me pritshmëritë e tregut. Shpejtësia me të cilën u finalizua operacioni përbën një konfirmim të mëtjshëm të vendosmërisë së Kompanisë për të siguruar vazhdimësi operative dhe vëmendje maksimale ndaj nevojave të pasagjerëve të saj.

Adria Ferries rinovon angazhimin e saj ndaj udhëtarëve, partnerëve tregtarë dhe rrjetit të agjencive, duke konfirmuar se besueshmëria, cilësia e shërbimit dhe kënaqësia e klientit do të vazhdojnë të jenë vlerat themelore të aktivitetit të saj.

Ankona, 12 qershor 2026

ADRIA FERRIES S.p.A.

